

**AKT – THEMELIMI  
(KONTRATË)  
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR**

**“ TecnoScavi Albania ” sh.p.k.**

**Ne:**

Unë, **Syrgen Cani**, i dtl. 28/04/1990, lindur në Shkodër dhe banues në La. Guerrile, nr. 82, Shkodër, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi letërnjoftim Nr.035837011, dhe nr personal ID: J00428111V, i vlefshëm deri më : 11/02/2030.

dhe

Unë **Roland Ribaj**, i dtl. 17/06/1975, lindur në Vlorë dhe banues në La. 1 Maji, pallati nr. 1141, Vlorë, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi letërnjoftim Nr.038519665, dhe nr personal ID: H50617090R, i vlefshëm deri më : 06/09/2032.

kemi vendosur:

**Neni 1**

Të themelojmë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar për të ushtruar veprimtarinë ekonomike e emërtuar **“ TecnoScavi Albania ” sh.p.k.** me ortakë:

z. **Syrgen Cani**, i dtl. 28/04/1990, lindur në Shkodër dhe banues në La. Guerrile, nr. 82, Shkodër, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi letërnjoftim Nr.035837011, dhe nr personal ID: J00428111V, i vlefshëm deri më : 11/02/2030.

dhe

z. **Roland Ribaj**, i dtl. 17/06/1975, lindur në Vlorë dhe banues në La. 1 Maji, pallati nr. 1141, Vlorë, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi letërnjoftim Nr.038519665, dhe nr personal ID: H50617090R, i vlefshëm deri më : 06/09/2032.

**Neni 2**

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar pa TVSH dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës të derdhur në kapitalin themelor.

**Neni 3**

Shoqëria e ka selinë e saj në Shkodër, Rruga Evlia Çelebiu, nr pasurie 2/1324-B8, zona kadastrale 8591, Shkodër. Shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filjal, përfaqësi, degë, si dhe t'i suprimojë ato.

#### **Neni 4**

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me kufi të pacaktuar e mbi 10 vjet. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë me vendim të ortakëve.

#### **Neni 5**

Kapitali fillestar themelor i Shoqërisë do të jetë 1.000.000 lekë (një milion), kapital i cili është i formuar tërësisht nga ortakët themelues të saj. Kuotat e kapitalit janë të ndara në 2 pjesë të barabarta me vlerë nga 500.000 lekë (pesëqind mijë) secili.

Secili nga ortakët zotërojnë:

Ortaku

**Syrgen Cani**, i dtl. 28/04/1990, lindur në Shkodër dhe banues në La. Guerrile, nr. 82, Shkodër, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi letërnjoftim Nr.035837011, dhe nr personal ID: J00428111V, i vlefshëm deri më : 11/02/2030 zotëron 1 kuotë me vlerë totale 500.000 lekë (pesëqind mijë) që mban 50% të kapitalit.

Dhe ortaku

**Roland Ribaj**, i dtl. 17/06/1975, lindur në Vlorë dhe banues në La. 1 Maji, pallati nr. 1141, Vlorë, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi letërnjoftim Nr.038519665, dhe nr personal ID: H50617090R, i vlefshëm deri më : 06/09/2032 zotëron 1 kuotë me vlerë totale 500.000 lekë (pesëqind mijë) që mban 50% të kapitalit.

#### **Neni 6**

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga ortakët. Rritja e kapitalit të ortakut nuk është e kufizuar.

#### **Neni 7**

Të gjitha pjesët e kapitalit themelor do të shlyhen në llogarinë e subjektit sapo të rregjistrohet dhe të hapet nr i llogarisë në një bankë të nivelit të dytë në teritorin e republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 8**

Objekti i aktivitetit ekonomik do të jetë:

Sipërmarrje ndërtimesh të veprave të ndryshme publike dhe private si: Ndërtim rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, metro, tunele. Ndërtim ujesjellesa, punime në diga, hidrocentrale, vepra kullimi e vaditje. Ndërtim ura dhe vepra arti, godine civile, industriale dhe turistike. Punime topogjeodezike, punime nëntokësore, punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime. Linja mbitokësore dhe nëntokësore për energjinë dhe telekomunikacionet, ndërtimin e veprave ujitëse, centraleve, objekteve turistike, objekteve ushtarake, objekteve të kultit, rrjetet inxhinierike, portet,

aeroportet, objektet industriale, projektet për përdorim të energjisë nga burimet e rinovueshme të gjitha restaurimet në përgjithësi, rikonstruksione të veprave të artit, montimet e konstruksioneve metalike, si dhe çdo ndërtim tjetër. Restaurime, shërbime hidrosanitare. Dhënie me qera e makinerive të rënda, makinerive punuese, gërmuese dhe pajisjeve, autoveturave, kamioncinave, furgona etj. . Prodhim dhe tregtim i materialeve të ndërtimit si asfalt, beton dhe inerte, materiale parafabrikate dhe prodhime të tjera betoni. Import-Eksport, agjensi turistike, servis ,tregtim karburante dhe vajra lubrifikante. Grumbullim dhe Transport i mbetejeve Inerte dhe Urbane. Demontim i armëve dhe paisjeve luftarake. Konsulencë teknike për realizim projektesh, konsulencë financiare dhe juridike. Shoqëria mund të krijojë partneritet me shoqëri të huaja ose mund t'i përfaqësojë ato. Shoqëria do të punojë me Rregjimin e Përpunimit Aktiv (RPA) dhe Rregjimin e Lejimit të Përkohshëm (RLP).

### **Neni 9**

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit, që lidhet midis palëve në mbështetje të ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 (Kodit të Punës), si dhe akteve të tjera nënligjore të dala në zbatim të tij.

### **Neni 10**

Ortakët nuk kufizohen në rritjen e kapitalit të shoqërisë.

### **Neni 11**

Shoqëria vepron në rregjimin e pronës dhe merr përsiper të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët themelues mbartin rrezikun e veprimtarisë së Shoqërisë në nivelin e kapitalit të investuar në Shoqëri.

### **Neni 12**

Mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të shoqërisë midis ortakëve dhe në mes të Shoqërisë dhe punonjësve brenda saj, si dhe me të tretët, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, çështja mbetet në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **Neni 13**

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërimit të saj.

### **Neni 14**

Organet e shoqërisë "**TecnoScavi Albania**" sh.p.k. janë :

Ortakët e shoqërisë.

Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i shoqërisë do të jetë z. **Syrgen Cani** , i dtl. 28/04/1990, lindur në Shkodër dhe banues në La. Guerrile, nr. 82, Shkodër, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi letërnjoftim Nr.035837011, dhe nr personal ID: J00428111V, i vlefshëm deri më : 11/02/2030.

Modalitete për ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga statuti i shoqërisë, ligji 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe statuti i shoqërisë, ligji Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

Ky akt – Themelim është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

**Datë, 25.09.2024**

**THEMELUESIT :**

**Syrgen Cani**



**Roland Ribaj**

